



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

PROJEKTLIGJ

Nr. _____/2015

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 076, DATË
12.2.2009, “PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM NË SEKTORIN E
TRANSPORTIT”¹**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 10076 datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 1
Objekti

“Ky ligj ka për objekt:

“1.Përcaktimin e parimeve dhe rregullave për veprimtarinë e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”.

“2.Përcaktimin e kritereve, procedurave dhe metodologjisë për përcaktimin e shumës përkatëse të dëmshpërblimit për dëmet e shkaktuara ndaj palëve të treta nga përdorimi i mjetit të transportit në RSH.”

¹Pjesërisht i përputhshëm me Direktivën 2009/103/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16 shtator 2009, për sigurimin e përgjegjesisë civile në lidhje me përdorimin e mjeteve motorike dhe për zbatimin me forcë të detyrimit për të marrë një sigurim të tillë, Numër CELEX 32009L0103, Fletore Zyrtare L 263, 07.10.2009, f. 0011 - 0031

Neni 2

Në nenin 3 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Në pikën 3, pas fjalëve “numri i rrotave” shtohen fjalët “subjekt i detyrimit për regjistrim”.

2. Në pikën 4 në fund të fjalisë shtohen fjalët: “4....., miratim i cili i njoftohet paraprakisht shoqërisë se sigurimit me shkrim.”

3. Pas pikës 5 shtohen pikat 5/1 dhe 5/2 me përmbajtje si më poshtë:

“5/1. “Drejtues i paautorizuar” është personi, i cili në rastin e aksidentit drejton mjetin pa miratimin e pronarit të mjetit, nuk është punësuar prej tij për të drejtuar mjetin, nuk është anëtar i familjes së tij, nuk e ka marrë mjetin në dorëzim nga mbajtësi, nuk është njoftuar paraprakisht shoqëria e sigurimit për miratimin e pronarit sipas parashikimit të pikës 4 të nenit 3.

5/2 “Miratim i pronarit” është autorizimi me shkrim i lëshuar nga pronari për përdorimin e mjetit nga persona të tjerë.”

4. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“Dëm pasuror” është dëmi i pësuar si rezultat i dëmtimit apo shkatërrimit të pronës, si dhe humbjes së të ardhurave si rezultat i vdekjes apo dëmtimeve trupore.

5. Pika 21 ndryshohet si më poshtë:

a) në fjalinë e parë, fjala “i shtetit” zëvendësohet me “i vendit”.

b) në shkronjën c), togefjalëshi “kryesisht, qëndrimi”, zëvendësohet me “qëndrim të përhershëm”.

c) në shkronjën ç), fjala i “i transportit” zëvendësohet me “motorik”.

6. Pas pikës 28 shtohen pikat 29, 30, 31 dhe 32 me përmbajtje si më poshtë:

“29. “Një ngjarje sigurimi” përfshin tërësinë e të gjitha dëmtimeve që shkaktohen si pasojë e një, apo disa aksidenteve, të lidhur me njëri tjetrin, pavarësisht numrit të të

dëmtuarve, pasurive, apo palëve të përfshira , e cila, kur ndodh, i jep të drejtën palëve të treta të dëmtuara të dëmshpërblehen nga siguruesi, sipas kritereve, procedurave, metodologjisë së përlllogaritjes të dëmshpërblimit të këtij ligji dhe rregullores në zbatim të tij, brenda kufijve dhe afateve të përcaktuara në këtë ligj.”

“30. “Kufiri minimal i përgjegjësisë” nënkupton shumat maksimale të dëmshpërblimit (për çdo figurë dëmi të njohur nga ky ligj) që Siguruesi merr përsipër, nëpërmjet kontratës së sigurimit, të dëmshpërblejë palët e treta ,të dëmtuara në një ngjarje sigurimi.”

31. “Sistemi bonus-malus” është sistemi i cili zbatohet për përcaktimin e nivelit të primit të sigurimit të detyrueshëm motorik, bazuar në historikun e dëmeve të të siguruarit.

32. Për qëllim të këtij ligji, sa herë që në ligj përmendet termi “sigurim i detyrueshëm motorik”, kuptohet edhe “sigurim i detyrueshëm për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”.

Neni 3

Në nenin 4 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Pika 2 ndryshon si më poshtë:

“2. Kur mjeti i transportit është subjekt i detyrimit për t’u regjistruar apo licencuar dhe, sipas ligjit, duhet të ketë një certifikatë regjistrimi apo licencimi, autoritetet përgjegjëse mund ta lëshojnë certifikatën e regjistrimit, certifikatën e kontrollit teknik, ose ndonjë dokument tjetër, të barasvlershëm me të, vetëm pasi drejtuesi i mjetit të transportit i provon këtij Autoriteti me dokumente se e ka lidhur kontratën e sigurimit të përgjegjësive së pronarit ose të përdoruesit të mjetit motorik si dhe sigurimin e pasagjerëve për mjetet në transportin publik.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me përmbajtje si më poshtë:

“4. Autoritetet përgjegjëse janë të detyruara të zbatojnë kërkesat e pikës 2 të këtij neni”.

Neni 4

Në nenin 5, në fund të fjalisë shtohen fjalët “i cili ka njoftuar paraprakisht me shkrim siguruesin.”

Neni 5

Në nenin 8, në pikën 2, fjala “e zbaton” zëvendësohet me fjalën “e ofron”.

Neni 6

Në nenin 9, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2.Kontrata për sigurimin e detyrueshëm, referuar shkronjës b të pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji mbulon dëmet e ndodhura në Republikën e Shqipërisë.”

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3.Kontrata për sigurimin e detyrueshëm karton jeshil, referuar shkronjës b të pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji mbulon dëmet e ndodhura në territoret e shteteve anëtare të sistemit të kartonit jeshil”.

Neni 7

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 10

Tarifat e primit të sigurimit të detyrueshëm

- 1. Shoqëria e sigurimit i përcakton vetë tarifat e primit të sigurimit të detyrueshëm, referuar pikës 1, të nenit 2 të këtij ligji.*
- 2. Shoqëria e sigurimit njofton Autoritetin brenda 10 ditëve përpara aplikimit të tarifave të reja të primit. dhe depoziton në Autoritet, bazat teknike dhe vlerësimet aktuariale të përdorura për llogaritjen e këtyre primeve të shoqëruara me opinionin e aktuarit të autorizuar të shoqërisë.*
- 3. Autoriteti, në funksion të mbikëqyrjes së veprimtarisë të shoqërisë së sigurimit, ka të drejtë të kthejë për rishikim tarifat e reja të primeve nëse konstaton se shoqëria e sigurimit nuk ka vepruar në me rregullat dhe parimet aktuariale.*
- 4.Autoriteti përcakton me rregullore bazën e të dhënave të përdorura për llogaritjen e tarifave të primit.”*

Neni 8

Pas nenit 10, shtohet neni 10/1 me përmbajtjen si më poshtë:

*“Neni 10/1
Sistemi Bonus-Malus*

- 1. Shoqëria e sigurimit duhet të përfshijë sistemin bonus-malus në përcaktimin e tarifave të sigurimit të detyrueshëm për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, sipas përcaktimeve të shkronjës b), pika 1 të nenit 2 të këtij ligji, të cilat i zbaton menjëherë pas përfundimit të afatit vjetor të kontratave të sigurimit në fuqi.*
- 2. Kriteret themelore të sistemit bonus-malus, kategoritë e mjeteve ku ai zbatohet si dhe të dhënat e nevojshme për zbatimin e tij do të përcaktohen nga Autoriteti.*
- 3. Shoqëria e sigurimit mund të vendosë kriteret shtesë mbi aplikimin e sistemit bonus-malus, të cilat nuk janë në kundërshtim me kriteret e përmendura në pikën 2 të këtij neni.*
- 4. Certifikata e historikut të dëmeve sipas shkronjës d), të pikës 1 të nenit 38 të këtij ligji do të jetë në formë elektronike dhe i vihet në dispozicion të siguruarve, sipas formës, metodës, afateve kohore dhe përmbajtjes të përcaktuara me rregulla të nxjerra nga Autoriteti.”*
- 5. Për shkelje të pikës 1 të këtij neni, Autoriteti mund të tërheq shoqërisë së sigurimit përkohësisht ose përfundimisht licencën për të ushtruar veprimtari në sigurimin e detyrueshëm, sipas përcaktimeve të shkronjës b), pika 1, të nenit 2 të këtij ligji.*

Neni 9

Në nenin 11, pika 2 ndryshon si më poshtë:

“2. Kërkesa për dëmshpërblim që rrjedh nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm, për të cilën janë të zbatueshme dispozitat e këtij ligji, sipas pikës 1 të këtij neni mund përfshijë dëmshpërblimin e dëmeve pasurore dhe jo pasurore. Detyrimi ndaj palëve të treta që lind nga një ngjarje sigurimi për siguruuesin ka karakter kontraktor, i cili buron nga polica e sigurimit e lidhur mes siguruarit dhe të siguruarit për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”

Neni 10

Në nenin 12 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Siguruesi përgjegjës është i detyruar të trajtojë kërkesën për dëmshpërblim për dëme pasurore dhe jopasurore dhe të kryejë njoftimin përkatës, sipas pikës 1 të këtij neni,

brenda 60 ditëve kalendarike nga data e plotësimit të dokumentacionit për dëmshpërblim. Nëse ky afat nuk është respektuar, interesat mbi shumën e llogaritur nga shoqëria e sigurimit apo gjykata, fillojnë pas përfundimit të këtij afati”.

2. Pas pikës 3, shtohen pikat 3.1, 3.2, 3.3, dhe 3.4, si më poshtë:

“3.1 Në rast se përfituesi nuk është dakord me vlerën e ofruar të dëmshpërblimit nga siguruesi, mund të paraqesë ankim pranë shoqërisë së sigurimit.

3.2 Shoqëria e sigurimit është e detyruar ti përgjigjet ankimit të palës së dëmtuar brenda 15 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së tij.

3.3 Pala e dëmtuar mund të ngrejë padi civile kundër siguruesit përgjegjës pas mbarimit të “ankimit në shoqërinë e sigurimit”, në rastet kur:

a) siguruesi përgjegjës nuk i përgjigjet palës së dëmtuar brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni;

b) pala e dëmtuar nuk është dakord me masën e dëmshpërblimit të ofruar nga siguruesi përgjegjës.

3.4 Afati i parashkrimit të padisë që rrjedh nga sigurimi i detyrueshëm sipas këtij ligji është përcaktuar në nenin 115, shkronja ç, të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe fillon nga data e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit”.

5. Pika 4 shfuqizohet.

6. Pas pikës 5 shtohen pikat 6 dhe 7 me përmbajtje si më poshtë:

“6. Për dëme pasurore me karakter material, kur shkalla e dëmtimit është e vogël, dhe vlerësohet deri në 200,000 lekë, afati i trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim është brenda 14 ditëve nga data e plotësimit të dokumentacionit.”

“7. Shoqëria e sigurimit duhet të kryejë pagesën e dëmshpërblimit vetëm në llogarinë bankare personale të të dëmtuarit dhe ose përfituesit. Pala e dëmtuar ose përfituesi në rast se merr shërbime nga mbrojtësi ligjor, për dëmet e ardhura si pasojë e një ngjarje sigurimi mund t'i paguajë deri në 5% të vlerës së dëmshpërblimit të përfituar.”

Neni 11

Në nenin 13 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Pika 1, ndryshohet si më poshtë:

“1. Rregullat, metodologjia e llogaritjes së dëmshpërblimit që mbulohet nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në zbatim të këtij ligji sipas pikës 1, të nenit 2 miratohen me vendim të Autoritetit dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

2. Pas pikës 2 shtohen pikat 3 dhe 4 si më poshtë:

“3. Vlerësuesit e dëmeve të licencuar nga Autoriteti janë të detyruar të zbatojnë rregulloren e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.”

“4. Përcaktimi i koeficientit të humbjes së aftësisë për punë nga një ngjarje sigurimi bëhet vetëm pranë IML (Instituti i Mjekësisë Ligjore). Personi i dëmtuar paraqitet pranë këtij institucioni për ekzaminimin fizik të tij. IML përcakton dhe dokumenton gjendjen shëndetësore, shkaqet dhe shkallën e paaftësisë.”

Neni 12

Në neni 17, pas pikës 2 shtohet pika 3 si më poshtë:

“3. Përpara lëshimit të kontratës së sigurimit të përgjegjësisë së pronarit ose përdoruesit të mjetit motorik për mjetet e transportit publik, siguruesi është i detyruar të lëshojë kundrejt pagesës së primit nga ana e të siguruarit policën e sigurimit të pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik, sipas përcaktimeve të pikës 2) të nenit 17 të këtij ligji.”

Neni 13

Në nenin 19 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Në pikën 2, gërma “b”, ndryshohet si më poshtë:

“në rast të paaftësisë të plotë të përhershme deri në 4,000,000 lekë, dhe për paaftësinë e pjesshme të përhershme në përpjesëtim me shkallën e paaftësisë.”

2. Pas gërmës “b” shtohet gërma “c” si më poshtë:

“Në rast të paaftësisë së përkohshme deri në 500.000 lekë në raport me periudhën e paaftësisë.”

Neni 14

Në nenin 20, pas pikës 2, shtohet pika 3 si më poshtë:

“3. Pronari i mjetit të transportit publik, sipas parashikimeve të pikës 1), të nenit 17 vendos në një vend të dukshëm të mjetit të transportit publik dhe pasqyron në biletë, emrin e shoqërisë së sigurimit të përcaktuar në kontratën e sigurimit, si dhe të drejtën e pasagjerit për të përfutuar nga kjo kontratë”

Neni 15

Në nenin 22 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Titulli i nenit ndryshohet si më poshtë:

“Mbulimi në sigurim”

2. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Pronari i mjetit motorik detyrohet të lidhë një kontratë të sigurimit të përgjegjësisë për dëmet pasurore dhe jopasurore që mund t’u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjete, me pasojë dëmtimin dhe humbjen e pronës, vdekjen, dëmtimet trupore dhe përkeqësimin e shëndetit.”

3. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Kontrata e sigurimit të detyrueshëm mbulon përgjegjësinë e të siguruarit, i cili për shkak të veprimeve apo mosveprimeve me faj të tij i shkakton dëm palëve të treta gjatë qarkullimit të mjetit në rrugë.”

4. Pas pikës 2 shtohen pikat 2.1, 2.2 dhe 2.3 me përmbajtje si më poshtë:

“2.1 Kontrata e sigurimit, sipas pikës 1 të këtij neni, mbulon edhe dëmet pasurore dhe jopasurore që mund t’u shkaktohen këmbësorëve, çiklistëve si dhe përdoruesve të mjeteve jo-motorike që lëvizin në rrugë.”

2.2 Kontrata e sigurimit, sipas pikës 1 të këtij neni, mbulon dëmet që shkaktohen nga mjete në lëvizje në rrugë dhe sipërfaqe të tjera në të cilët ka trafik, mjete të cilat janë subjekt i regjistrimit sipas legjislacionit në fuqi.

2.3 Dëmet e shkaktuar si pasojë e mos mirëmbajtjes apo mos ndërtimit të segmenteve rrugor dhe ose veprimeve/mosveprimeve, janë përgjegjësi civile e Autoritetit rrugor

shqiptar apo ndonjë autoritetit tjetër pronar i rrugëve, i cili ka detyrimin ligjor të rimbursojë shoqërinë e sigurimit e cila ka paguar dëmet te pala e dëmtuar.

Neni 16

Në nenin 23 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Shkronja a) ndryshohet si më poshtë:

a) drejtuesi i mjetit shkaktar i aksidentit, duke përfshirë këtu edhe trashëgimtarët ligjorë të tij, për dëme si rezultat vdekjeje, dëmtimi trupor apo përkeqësim shëndeti të drejtuesit si rezultat i këtij aksidenti;

2. Shkronja c) ndryshohet si më poshtë:

c) çdo person, që ndodhet me vullnetin e vet në mjetin motorik të vjedhur, shkaktar të aksidentit, kur provohet se personi ishte në dijeni të këtyre rrethanave;

3. Në shkronjën d), togefjalëshi “përvetësuar mjetin motorik në mënyrë të kundërligjshme” zëvendësohet me togefjalëshin “vjedhur mjetin motorik”.

Neni 17

Në nenin 24 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 1 pas shkronjës “dh”, shtohen shkronjat “e”, “ë”, “f” dhe “g” me përmbajtje si më poshtë:

e) drejtuesi nuk garanton ngarkesën që transporton duke u bërë shkak për aksident.

ë) drejtuesi ka marrë në automjet një numër më të madh personash se sa lejon leja e qarkullimit.

f) drejtuesi i mjetit që vendos të miturin në kundërshtim me dispozitat e kodit rrugor, për dëmet që ka pësuar i mituri.

g) pronari i ri i mjetit nuk ka njoftuar shoqërinë e sigurimit për ndryshimin e pronësisë së mjetit, sipas pikës 1 të nenit 28 të këtij ligji.

2. Në pikën 1, në shkronjën “ç”, hiqet togfjalëshi “*mbi kufijtë e lejuar*”.

3. Në pikën 2 togfjalëshi “...në shkronjat “a” deri në “dh” të pikes 1 të këtij neni”, zëvendësohet me togfjalëshin “...në shkronjat “a” deri në “g” të pikes 1 të këtij neni”.

4. Në pikën 3, togfjalëshi “...sipas shkronjës “d” të pikës 1 të këtij neni...” zëvendësohet me togfjalëshin “sipas shkronjave *a*”, “*b*”, “*c*”, “*ç*”, “*d*”, “*dh*”, “*e*”, “*ë*”, “*f*” dhe “*g*” të pikës 1 të këtij neni”.

Neni 18

Në nenin 25 pika 2 hiqet.

Neni 19

Në nenin 26, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 2, shkronja “b”, ndryshon si më poshtë:

b) për dëme jopasurore, të shkaktuara nga një aksident ose seri aksidentesh, të ardhura nga një ngjarje sigurimi:

- | | |
|---|-------------------------------|
| <i>i) Dëmi moral nga vdekja</i> | <i>deri në 500 000 lekë</i> |
| <i>ii) Dëmi ekzistencial nga vdekja</i> | <i>deri në 500 000 lekë</i> |
| <i>iii) Dëmi moral nga paaftësia totale e përhershme</i> | <i>deri në 2 000 000 lekë</i> |
| <i>iv) Dëmi ekzistencial nga paaftësia totale e përhershme</i> | <i>deri në 1 500 000 lekë</i> |
| <i>v) Dëmi biologjik nga paaftësia totale e përhershme</i> | <i>deri në 1 000 000 leke</i> |
| <i>vi) Dëmi moral nga paaftësia e pjesshme e përhershme</i> | <i>deri në 500 000 lekë</i> |
| <i>vii) Dëmi ekzistencial nga paaftësia e pjesshme e përhershme</i> | <i>deri në 500 000 lekë</i> |
| <i>viii) Dëmi biologjik nga paaftësia e pjesshme e përhershme</i> | <i>deri në 1 000 000 lekë</i> |
| <i>ix) Dëmi moral nga paaftësia e përkohshme</i> | <i>deri në 200 000 lekë</i> |
| <i>ix) Dëmi ekzistencial nga paaftësia e përkohshme</i> | <i>deri në 200 000 lekë</i> |
| <i>x) Dëmi biologjik nga paaftësia e përkohshme</i> | <i>deri në 200 000 lekë</i> |

2. Pika 3, ndryshon si më poshtë:

3. Në rast se ka disa palë të dëmtuara nga një ngjarje sigurimi dhe vlera totale e dëmshpërblimit për dëmin pasuror si dhe vlera totale e dëmshpërblimit për dëmin jopasuror sipas figurave i tejkalon shumat e përcaktuara në pikën 2, shkronjat “a”, “b”, “c”, të drejtat e palëve të dëmtuara ndaj shoqërisë së sigurimit zvogëlohen në mënyrë përpjesëtimore për secilën formë të dëmit pasuror dhe jo pasuror “ndërmjet të gjithë të dëmtuarve deri në përfundim të gjithë shumës së siguruar sipas kontratës së sigurimit.

Neni 20

Neni 29 i ligjit ndryshon si më poshtë:

1. Në pikën 1 pas fjalisë së parë shtohet fjalia me përmbajtje:

Byroja duhet t’i japë palës së dëmtuar një arsyetim me shkrim në lidhje me shumën dhe pagesën e kompensimit.

2. Në pikën 2 në fund të fjalisë shtohen fjalët “duke njoftuar në çdo rast shkaktarin përgjegjës për dëmin”.

3. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Byroja mund t’ia delegojë trajtimin e një dëmi të tillë njërit prej anëtarëve të vet, i cili është e detyruar të trajtojë dëmin me shpenzimet e fondit të kompensimit sipas rregullave të përcaktuara nga Byroja dhe të miratuara nga Autoriteti.”

4. Në pikën 4, pas fjalisë së parë shtohet fjalia e dytë me përmbajtje si më poshtë:

Në rast të një padie civile për shpërblim dëmi të ngritur nga pala e dëmtuar kundrejt byrosë, shkaktari i dëmit duhet të njoftohet për të marë pjesë si palë në këtë proces civil.

5. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me përmbajtje si më poshtë:

“5. Byroja në trajtimin, vlerësimin dhe dëmshpërblimin e dëmeve që trajtohen prej Fondit të Kompensimit i nënshtrohet dhe zbaton të gjitha kriteret, procedurat dhe shumat përkatëse të dëmshpërblimit sipas këtij ligji.”

Neni 21

Në nenin 30 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në titullin e nenit pas fjalës “mjeteve” shtohet fjala “motorike”.
2. Në pikën 1 pas fjalës “mjeteve” shtohet fjala “motorike”.
3. Në pikën 2 përpara fjalës “jopasurore” shtohet fjala “pasurore”.
4. Në pikën 4 pas fjalës “të mjetit” shtohet fjala “motorik”.
5. Në pikën 5, fraza “përvetësuar në mënyrë të kundërligjshme” zëvendësohet me fjalën “vjedhur”.

Neni 22

Në nenin 35, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Titulli i nenit ndryshohet si më poshtë:

“E drejta e kompensimit bazuar në sigurimin kufitar”

2. Në pikën 1, hiqen fjalët “ose te byroja nëse parashikohet ndryshe”.
3. Pika 4 shfuqizohet.

Neni 23

Në nenin 38, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Shkronja “ç” e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

ç) mbledh dhe ruan të dhëna për shoqëritë e sigurimit, që ofrojnë sigurim të detyrueshëm, si dhe të dhëna në lidhje me emrin dhe adresat e përfaqësuesve të trajtimit të dëmeve të këtyre shoqërive në çdo shtet;

2. Në pikën 3 pas fjalisë së parë shtohet fjalia e dytë me përmbajtje si më poshtë:

“Periudha kohore, që duhet të ruhen të dhënat e përmendura në pikën 1 të këtij neni është minimalisht 7 vjet, nga data e përfundimit të regjistrimit të mjetit ose përfundimit të kontratës së sigurimit.”

Neni 24

Në nenin 39 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pas pikës 1 shtohet pika 1.1 me përmbajtje si më poshtë:

“Qendra e informacionit i mundëson palës së dëmtuar të dhëna në lidhje me emrin dhe adresën e pronarit ose përdoruesit të mjetit motorik, shkaktar të dëmit, nëse pala e dëmtuar ka një interes të ligjshëm për marrjen e këtij informacioni. Për qëllimet e kësaj dispozite, qendra e informacionit i drejtohet në veçanti shoqërisë së sigurimeve ose organit përkatës të regjistrimit të automjeteve. Në rastet e mjeteve të cilat janë të përjashtuara nga sigurimi i detyrueshëm sipas pikës 2 të nenit 2 të këtij ligji, qendra e informacionit e informon palën e dëmtuar në lidhje me autoritetin përgjegjës për pagesën e dëmshpërblimit.

2. Pas pikës 7 shtohet pika 8, me përmbajtje si më poshtë:

8. E drejta për të marrë informacion nga pala e dëmtuar sipas pikës 1 të këtij neni është e vlefshme edhe 7 vjet pas ndodhjes së aksidentit.

Neni 25

Në nenin 44 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 4, fjalia e parë ndryshohet, si më poshtë:

“4. Fondi i garancisë së kartonit jeshil përdoret:

a) në rastet e mospërmbushjes së detyrimeve financiare të një anëtari të byrosë, përgjegjës për pagesën e dëmshpërblimit, sipas rregullave të sistemit të kartonit jeshil;”

2. Shkronja c e pikës 4 ndryshohet si më poshtë:

c) në rastet e paaftësisë pagueuse të një anëtari të byrosë.

3. Pas pikës 5 shtohet pika 6 me përmbajtje si më poshtë:

“6. Kur shoqëria e sigurimit shkel dispozitat e këtij neni Autoriteti merr masa përkatëse sipas këtij ligji.”

Neni 26

Në nenin 45 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1 pas fjalës *“administrohet”* shtohet togfjalëshi *“sipas rregullores së hartuar:*

2. Në pikën 2 hiqen fjalët *“në këto lloj sigurimesh”* dhe zëvendësohet me fjalët *“në sigurimin e detyrueshëm motorik dhe sigurimin e pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik”*.

3. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Autoriteti vendos çdo vit shumën e kontributeve sipas pikës 2 dhe shkronjës “b” të pikës 3, e cila llogaritet sipas rregullores të hartuar nga Autoriteti për mënyrën e llogaritjes së këtyre kontributeve si dhe afatet e pagesës së tyre.”

Neni 27

Në nenin 46 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Shtohet titulli i nenit me emërtimin *“Administrimi i Fondit të Garancisë së Kartonit Jeshil dhe Fondit të kompensimit”*.

2. Në pikën 2 hiqet fjalia e dytë.

3. Pika 3 hiqet.

4. Pika 4, bëhet pika 3 dhe pas fjalës *“parashikimet”* pjesa *“e neneve 48 pika 1 e 49 pikat 1 e 2 të këtij ligji”* zëvendësohet me *“nenet 44 e 45 të këtij ligj”*. Fjalia e dytë e pikës 4 ndryshohet si më poshtë:

“Kur shoqëria e sigurimit shkel dispozitat e parashikuara në këtë pikë Autoriteti mund ti tërheq shoqërisë së sigurimit përkohësisht ose përfundimisht licencën për të ushtruar veprimtari në sigurimin e detyrueshëm”.

Neni 28

Në nenin 52 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 5, pas gërmës “d” shtohet gërma “dh” me këtë përmbajtje:

dh) shkel dispozitat e nenit 10/1 të këtij ligji.

2. Në pikën 7, fjalët “në pikat 3” zëvendësohet me fjalët “në pikat 2”.

Neni 29

Në nenin 53 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në shkronjën ç), të pikës 1 hiqen fjalët “ dhe garancisë”:

2. Në pikën 1, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d” me përmbajtje si më poshtë:

d) nuk njofton Autoritetin sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 56 të këtij ligji;

Neni 30

Pas nenit 58 shtohet neni 58/1 me përmbajtjen si më poshtë:

“Neni 58/1

Të gjitha praktikat e dëmshpërblimit në proces trajtimi me datë ngjarje sigurimi pas hyrjes në fuqi të ligjit 10076, dt.12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, do të trajtohen sipas parashikimeve të këtij ligji.”

Neni 31

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryetari

Ilir Meta